

# MOTIVACIONI I BESIMIT FETAR

**Prof. Dr. Hüseyin Peker**

*Përkthyes: Prof. asc. Dr. Feim D. Gashi*

Pse njerëzit besojnë? Pse njerëzit besojnë në një fuqi me të fortë se vetvetja, në një fuqi mbinatyrore apo supreme, e njohin atë dhe tregohen besnikë ndaj asaj fuqie, apo pse adhurojnë atë fuqi? Pse disa njerëz përkushtohen plotësisht në fe dhe përpiqen të përmbushin të gjitha urdhëratë e All-llahut në nivelin më të lartë, ndërsa disa të tjerë, besimin në All-llahun e perceptojnë si një iluzion dhe besojnë se nuk ekziston një Krijesë (Subjekt) e tillë?

Janë duke u bërë përpjekje në shumë fusha shkencore për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, pra rreth motivimit të besimeve fetare, emocioneve, intelektit dhe mbi tiparin socio-kulturor të njerëzve brenda këtij kuadri. Ne do të mundohemi që këtu t'i cekim disa nga faktorët kryesor që ndikojnë në besimin e njeriut në All-llahun Fuqiplotë.

## **Disa nga faktorët ndikues për të besuar në Zot dhe fe**

Njeriut është një krijesë i cili posedon veçori biologjike, psiko-sociologjike dhe kulturore. Në të shumtën rasteve këto veçori kanë efekte të dukshme dhe paksa të përziera. Shumë efekte janë të ndërthurura në çështjen e besimit në Zotin dhe drejtimin e fes, por këto efekte mund të ndryshojnë nga personi në person. Prandaj do të mundohemi t'i cekim dhe t'i shpjegojmë disa faktor që janë më kryesorët.

### **1. Imitimi apo mësuaria nga modeli**

Njeriut është krijesë sociale. Jeton në mesin e një komuniteti. Ai ndjen nevojë për të tjerët dhe nga ata mëson shumë gjera. Për arsye se ai lind në prani të prindërve. Çdo fëmijë që rritet dhe zhvillohet ka nevojë për prindër ose të paktën ka nevojë për tu rritur.

Nëse e shikojmë nga këndvështrimi i fëmijëve, vërejmë se familja është një institucion në të cilën fëmijët janë nën përkujdesjen e saj, sidomos në zhvillimin fizik dhe atë arsimor. Pra fëmijët në mesin familjar zhvillohen nga aspekti fizik dhe ai moral, ata po ashtu janë edhe nën ndikimin social-kulturor, kështu që fëmijët nga familja dhe rrethi përfitojnë edhe formimin e tyre fetar.

Periudha fëmijërore ndërmjet 2 deri 6 vjeç është periudha që imitimi është në shkallën më të lartë, kështu që gjatë kësaj periudhe prindërit e përbëjnë modelin kryesor për fëmijët e tyre. Fjalët dhe sjelljet e tyre fetare imitohen nga ana fëmijëve. Tashmë shumica e prindërve mundohen t'ia shpjegojnë fëmijëve që besimin dhe adhurimet t'i praktikojnë në formën më të mirë. Kështu që, me kalimin e kohës fëmijët do të fillojnë që edhe në vepra të shprehin dhe praktikojnë besimin dhe sjelljet fetare të prindërve të tyre. Andaj dhe mund të themi se mënyra e të besuarit dhe forma e sasia e të praktikuarit të parimeve fetare kanë influencën më të madhe në karakteristikat fetare të fëmijët dhe sidomos në formimin e personalitetit të tyre fetar.

Hulumtimet e bëra kanë treguar se prindërit janë faktorët kryesor në edukimin dhe formimin e besimit fetar të fëmijët. Shembull një hulumtim që është bërë mbi 800 nxënës të shkollave të larta në Australi, ka nxjerr si rezultat se faktorët kryesor në formimin e besimit janë:

Faktorët	Katolikët	Anglikanët	Çifutët	
1. Prindërit	%55	%39	%51	
2. Shoqëria	%11	%24	%12	
3. Zyrtaret e Kishës (udhëheqësit fetarë)	%8	%17	%6	
4. Mësuesit	%16	%10	%6	
5. Miqësia	%6	%5	%18	

Kjo tablo na tregon se te të gjithë grupet e nxënësve bindjet fetare të nënës dhe babait janë më shumë efektive se sa faktorët tjerë.<sup>1</sup>

Edhe pse fëmijët më vonë për nga aspekti i inteligjencës zhvillohen më shumë dhe janë nën ndikim e faktorëve tjerë të mjedisit (disa prej tyre bëjnë kritika, ndërrojnë besimin ose nuk e pranojnë fare besimin e prindërve), prapë se prapë shumica prej tyre jetën e vazhdojnë duke qenë të lidhur ngushtë ndaj principeve fetare që i kanë mësuar nga prindërit e tyre.

## 2. Dobësia dhe pafuqia

Njeriu është i fort edhe i dobët sipas vendit dhe rrethit ku jeton. Në kohën e lindjes ai është shumë i dobët, por edhe pse me kalimin e kohës shumë gjera mund t'i kryejë me fuqinë entij personale, megjithatë ai do të has në vështirësi që nuk do t'i mjaftoj kjo fuqi. P.sh. sëmundjet, aksidentet e trafikut, tërmetet, fatkeqësitë mbytëse, vdekja etj.

Ja pra dobësia dhe pafuqia e njeriut e detyron atë që vetën ta sigurojë nga rreziqet e lartpërmendura, pra e ndjen të nevojshme që të struket në mbrojtje të një Superfuqie të pafund. Zija Dalat jep këtë shembull: "Jeni duke parë një nënë, djali i së cilës ndodhet në shtratin e vdekjes dhe asnjë doktor nuk mund ta ndihmojë. Atë po e varrosni në varrin e errët, ku nuk depërton as drita dhe era më e vogël, kurse dikur ajo nënë këtë fëmijë e mbronte edhe nga gjerat më të vogla. Pastaj uleni pranë dhe pyetni ku shkoi ai? U zhduk? Dhe mendoni se çka u bë me atë. Tash ju është kujtuar se fuqia e njeriut, pasuria tokësore, parat, hamamet, pallatet, vendet e punës janë shumë të dobëta përballë jetës që vazhdon dhe sidomos përballë vdekjes e cila vjen shumë shpejt. Andaj ju gjithsesi duhet të gjeni një superfuqi mbinatyrore që do t'ju ngushëllojë në netët me vaj, pa gjumë e pa shpresë. Dhe do të filloni të mendoni për Kazan dhe Kaderin ose mbi një fuqi filozofike mbi natyrore. Shembulli tjetër: Një despot tashmë është afruar drejt jush. Dhe po jua grabitë pasurinë e vetme që posedoni. Kurse ju keni të drejt të posedoni atë pasuri. Por ai është mashtrues dhe i fuqishëm. Jeni ankuar neper gjykata dhe keni konsultuar avokatë të ndryshëm. Por nuk ia keni aritur të merrni të drejtën tuaj. Kështu që ose do të uleni dhe do t'i luteni Allahut me një bindje shumë të fort ose jetën do ta vazhdoni me ndonjë mendim filozofik, i cili ndoshta do t'ju ngushëllojë pak.<sup>2</sup>

Sipas Freud dhe Marx feja është ikje nga realiteti, dhe një mjet kompensimi. Ferudi thotë se feja është një produkt i dobësisë se njeriut ndaj shoqërisë njerëzore dhe natyrës. Freudi vazhdon të thotë se shoqëria e pengon një pjesë të rëndësishme të dëshirave instinktive të njeriut. Gjithashtu edhe fuqitë mbi natyrore pengojnë një pjesë të rëndësishme të dëshirave

<sup>1</sup> Grom Bernhart, Religion Psychologie, Munchen und Vandenhock, Transmeton Prof. Dr. Hüseyin Peker, Din Psikolojisi, Shtëpia Botuese Çamlıca, 1992, f. 77

<sup>2</sup> Ziya Dalat, Çocuk ve Genç Ruh, Ankara, 1956, f.365

dhe veprave të tij. Kur njeriu e kupton se nuk mund t'i përballojë natyrën dhe shoqërisë, ai ndjen një frikë të madhe dhe në mendjen e tij krijon një realitet mbi Perëndinë. Simbas Freudit ky është iluzion i cili njeriu e kthen në periudhën e fëmijërisë. Kur njeriu arrin t'i mos i kontrollojë rreziqet që vijnë nga jashtë apo nga brenda dhe të ballafaqohet me to, atij i kujtohet një provë që ka përjetuar gjatë fëmëjrisë dhe i kthehet asaj. Përvoja në fjalë tregon që fëmija e beson që babai i tij ka një fuqi mbi natyrore, i nënshtrohet urdhrave dhe ndalesave të tij, shpreson se do ta fitojë dashurinë dhe veten do ta ndien më të sigurt pran tij.<sup>3</sup>

Edhe Marxi mendon se vetëm privimi ekonomik dhe kushtet e dobëta financiare, njeriu e detyrojnë të strehohet tek feja. Sipas tij, feja për njerëzit është (Afjon) opium. Pra njerëzit që janë të privuar për në aspektin ekonomik janë të dehur prandaj dhe me ndihmën e fesë ata humbin reaksionet që kanë.

Sipas një hulumtimi të bërë është konstatuar se njerëzit bëjnë lutje më së shumti kur hasin në ndonjë pengesë gjatë jetës.<sup>4</sup>

Sipas Vergotes, momentet e rrezikshme njeriu e lidhin me Zotin.<sup>5</sup>

Edhe në Kur'anin Famëlartë është cekur se njeriu gjatë momenteve të vështira më shumë i lutet Allahut, kurse pas kalimit të atyre momenteve ai e harron Allahun<sup>6</sup>, prandaj dhe do të ishte më mirë që në çdo moment ta kujtojmë dhe ta falënderojmë Zotin e botëve.

Kur njeriu gjatë jetës së tij ballafaqohet me pengesa dhe vështirësi të pamposhtshme, ai duke iu drejtuar fesë mbështet tek Allahu dhe gjen ngushëllim e optimizëm, kështu pra besimi është fenomen inkurajues.

Por duhet të dimë se dobësia apo pafuqia njeriu e shpjen kah feja vetëm për një moment. Nëse feja nuk ka mbështetje të brendshme (emocione) dhe mendore, ky kthim nuk është i përhershëm, siç u tha më lartë në Kur'anin Famëlartë, kur kalojnë momentet e rrezikshme njeriu përsëri e harron Allahun xh.sh.

Ka raste kur disa pengesa ose dobësi tek disa njerëz ndikojnë në mënyrë negative dhe bëhen faktorë kryesor që e largojnë atë nga besimi, e fusin në rrugën që ta mohojë ekzistimin e Allahut xh.sh. <sup>7</sup>

### **3. Nevoja e orientimit apo lidhjes në Një Entitet (Krijesë)**

Erich Fromm thotë se te çdo njeri ka një sistem të orientimit dhe lidhjes. Ky sistem është shumë i fuqishëm dhe është pjesë e të ekzistuarit. Nuk ka burim më të fort te energjisë tek njeriu se ky burim. Feja është një nevojë universale pasi që njeriu e orienton në këtë drejtim. Njeriu ka nevojë të orientohet dhe të drejtohet ndaj një qëllimi andaj e ndjen një nevojë shpirtërore. Ai mund të adhurojë një kafshë, pemë, idhull i bere nga guri ose druri, Zotin e padukshëm, ndonjë person që ka dukuri të shejtanit, komb, paraardhës, parti, klasë, paranë apo suksesin.<sup>8</sup>

Sipas Frommit, individi për t'i shpëtuar adhurimit të një qenie më të ulët (sic është idhulli, kafsha, njeriu, etj.) aj gjithsesi duhet që ta miratojë dhe të lidhet ngushtë me një religjion që ka nivelin më të lartë.<sup>9</sup>

---

<sup>3</sup> Erich Fromm, Psikanaliz ve Din, Përkthyes Şükrü Alkaput, İstanbul, 1990, f.22

<sup>4</sup> Vergote, Antione, Psychologie Religieuse, Bruxelles, 1966, Transmeton Prof. Dr. Hüseyin Peker, Din Psikolojisi, Shtëpia Botuese Çamlıca, f.79

<sup>5</sup> Vergote, po aty, f.79

<sup>6</sup> Kur'ani, Zummer,49: Junus,12

<sup>7</sup> Hayati Hökeleklı, Din Psikolojisi, Shpija Botuese Türkiye Diyanet Vakfi, 1998, f.92

<sup>8</sup> Fromm, po aty, f.35

<sup>9</sup> Fromm, po aty, f.39

Lidhja apo orientimi ndaj një krijese e cila është më e fort se krijesat tjera, njeriut i jep një besim për dëshirat, iluzionet dhe ëndrrat. Gjithashtu kjo ndjenjë e fesë atij mund t'ia reduktojë shqetësimet, ankthin dhe pesimizmin në jetë.

#### **4. Arsyetimi dhe kënaqësia mendore**

Njeriu është krijesë që mendon, ai gjerat mundohet t'i arsyetojë, andaj qysh në moshën 2-3 vjeçare fillon t'i pyes prindërit dhe të afërmit për gjerat që ndodhen rreth tij, mundohet të gjejë përgjigje që e kënaqin apo e bindin. Me kalimin e kohës gjerat fillon t'i kuptojë më mirë edhe nga aspekti metafizik.

Te shumë njerëz hasim në disa pyetje të cilat njerëzit i detyrojnë të mendojnë më thellësisht. Disa nga këto pyetje janë: Si është krijuar njeriu dhe gjithësia? Ku e kanë fillimin këto? Si është krijuar njeriu kaq i përsosur, zbulues, që mendon, arsyetues dhe folës? Cili është qëllimi i ekzistencës? Kush e rregullon dhe kujdeset për këtë gjithësi që vepron pa asnjë të metë? Të gjitha këto a janë të krijuara nga vetvetja, rastësisht ose a janë krijuar (vazhdojnë të krijohen) nga një Krijues? A është vdekja fundi i cdo gjëje, me vdekjen a përfundon gjithçka, ose a ka jetë tjetër dhe kur fillon ajo?

Çdo njeri mundohet që vetes t'i gjejë një vend në gjithësi, veten e vlerëson dhe mendon se çka do të behet me ne në fund të kësaj jete. Kur njeriu fillon të mendojë se të gjitha këto mund të kontrollohen dhe drejtohen vetëm nga një Superfuqi, atëherë ky mendim ose bindje atë e detyron të besojë në Krijuesin e gjithësisë Allahun xh.sh.

Edhe Erich Fromm thotë se njeriu është i obliguar të tregojë vetes për vlerën e ekzistencës së tij.<sup>10</sup> Shumë njerëz lidhjet rreth ekzistimit të tyre me gjithësinë dhe projektin e universit, përgjigjet më të sakta i gjejnë në fe, atëherë ata domosdo i drejtohen fesë dhe i besojnë Zotit. Megjithë atë Vergote mendon se motivi kryesor nuk është vetëm përpjekja mendore që njeriun e shtyn të besojë fe.<sup>11</sup>

Në Universitetin "19 Maj" të Turqisë, në degën e psikologjisë, njëri nga studentët në lidhje me këtë ka deklaruar: A mendoni se një veturë, pjesët e se cilës janë të shumta rastësisht janë bashkuar me njëra me tjetrën dhe kjo veturë vetvetiu punon në rregull? A është e mundur të gjitha pjesët e motorit të bashkohen dhe të përbehet motori? Apo të gjitha këto të përbejnë veturën dhe ajo veturë të punojë në mënyrë të rregullt, pra pa ndërhyrë askush? Nëse mendoni se kjo nuk është e mundur, atëherë si është e mundur që kjo gjithësi, njerëzit, shtazët, bimët, gjithësia etj. të ekzistojnë (përbehen) rastësisht?

#### **5. Frika**

Frika është një motiv i rëndësishëm në sjelljen e njeriut. Individët vazhdimisht gërshetohen me frikën. P.sh. njeriu frikësohet nga sëmundje të ndryshme, ndeshje komunikacioni, humbja, problemet financiare, tërmeti dhe nga vdekjea. Përveç kësaj, gjatë jetës ndodhin vazhdimisht edhe raste që na përkujton ose na sjellin frikën. Frika e fëmijës se do të dënohet për dëmet e bëra, frika e nxënësit se do të marr not të dobët, frika se do të ngelë, frika e një të riu se nuk do të marr përgjigjeje pozitive nga një femër që e dashuron shumë, frika e një të riu që ka përfunduar shkollën se nuk do të gjejë punë, frika se do të humb punën që ka, frika se fëmija do të humb shëndetin, frika e mossuksesit etj.

Te gjitha këto bashkë me friken tek individi krijojnë shqetësim dhe brengosje. Në fakt frika njeriun e ruan nga gjendjet dhe gjerat e rrezikshme, ajo e mbron njeriun nga ana fizike,

---

<sup>10</sup> Fromm, po aty, f.33

<sup>11</sup> Vergote, po aty, f.166

mendore, statusi social, roli etj. në mënyrë që të vazhdojë dhe ruajë bilancin, me fjalë tjera, ndjenja e frikës është e nevojshme sepse ajo siguron pëlqimin dhe vullnetin për jetë.<sup>12</sup>

Por edhe pse njerëzit mundohen për të zgjidhur situatën e frikës, ose mundohen që të mësojnë që të jetojnë së bashku më frikën, struktura e tij e krijimit nuk e le pa frikë.

Në kohërat e lashta njerëzit gjërat e frikshme i kanë bërë idhuj dhe kanë filluar t'i adhurojnë ato. Pra kanë adhuroar fuqitë natyrore si hënën, yjet, diellin (natyralizëm), për t'i shpëtuar shpirtrave të ligj kanë adhuroar shpirtrat (animizëm) e mirë dhe kanë kërkuar ndihmë nga ta, kështu që për herë të parë kanë dal ne skenë edhe llojet e adhurimeve.

Edhe sot njerëzit gjatë momenteve të frikës më shumë i luten All-llahut dhe bëjnë dua. Kështu që njeriu veten e ndien më të qet dhe më të sigurt. Ne lidhje me këtë janë bërë shumë hulumtime shkencore të cilat kanë vërtetuar një gjë të këtillë. Sipas një hulumtimi, rinjtë më së shumti u janë drejtuar duasë, kur kanë qenë në këto momente: Shqetësim për të ardhmen, shpresë për të t'iu falë mëkatet, dëshira që të arrin sukses ne provim, pikëllimi për vdekjen e një të dashuri, kërkimi i ndihmës dhe sigurisë gjatë momenteve të rrezikshme dhe sëmundjes, etj..<sup>13</sup> Pas gjithë këtyre fjalëve lirisht mund të themi se ekziston një ndjenje e frikës.

Andaj frika është një motiv efektiv i cili ndikon tek besimi në All-llahun xh.sh. dhe në adhurimet ndaj Tij. Pra njeriu ka nevojë të strehohet tek All-llahu xh.sh që në momentet e frikës veten ta ndijë më të siguritë.

## **6. Dëshira për pavdekësi**

Njeriu nga njëra anë e di se nuk ka shpëtim nga vdekja kurse në anën tjetër ka dëshirë të jetë i pavdekshëm. Kjo dëshirë e madhe gjendet në strukturën esenciale të njeriut, të cilën më së miri e kuptojmë tek qëndrimet e fëmijëve.

Në lidhje me vdekjen, një fëmijë 4-5 vjeçar kishte diskutuar me nënën e tij:

Nënë çka do të thotë vdekje?

Njeriut i ndalet zemra dhe i ndalet fryma, kështu që ai mbetet i pa lëvizshëm.

Mirë, por çka ndodh me folurit e tij?

Nuk e di. Disa thonë dhe besojnë se njeriu pasi që të vdes kalon në botën tjetër dhe vazhdon të jetojë atje. Kurse disa nuk i besojnë kësaj.

Ne besojmë ne këtë, a po nënë? (me entuziazëm).<sup>14</sup>

Një fëmijë tjetër pasi që kishte pyetur se “a i mbyllin sytë njerëzit pasi që të vdesin?” kishte vazhduar dhe kishte thënë “unë kur të vdes nuk do t'i mbyll sytë, por do të vazhdoj dhe të shikoj për rreth”. Pra me këtë kuptohet se njeriu ka dëshirë të madhe për të jetuar,<sup>15</sup> ai i reziston vdekjes dhe nuk ka dëshirë për të vdekur. Fëmijët me këto pyetje dëshirojnë të dinë se vdekja nuk është fundi i gjithësisë, kanë shpresë se jeta nuk do merrë fund asnjëherë.<sup>16</sup>

Njeriu nuk dëshiron të vdes apo të zhduket, andaj vdekja tek ai krijon frikë, shqetësim dhe brengosje. Ky shqetësim është shumë i madh, sipas Özcan Köknelit, frika e vdekjes dhe

---

<sup>12</sup> Özcan, Köknel, Korkular, İstanbul, 1991, f.17

<sup>13</sup> Hayati Hökelekli, Ergenlik çağı Gençlerinin Dini Gelişimi, 1983, f.87

<sup>14</sup> Arthur T. Jersild, Çocuk Psikolojisi, Perkteu Gülseren Günçe, Şpija Botuese Ankara Üniversitesi Eğitim Fakültesi, Ankara, 1979, f.504

<sup>15</sup> Jersild, po aty, f.503

<sup>16</sup> Hüseyin Peker, Din ve Ahlak Eğitimi, f.63

shurajes janë pikat kryesore të cilat e detyrojnë njeriun të besojë dhe veprojë punë të mbara, kështu që për t'i shpëtuar kësaj frike njerëzit kanë besuar edhe në mos vdekjen e shpirtit.<sup>17</sup>

Hulumtimet e bëra kanë treguar se mesazhi i cili buron nga feja mbi vdekjen ka efekte pozitive në çështjen e besimit në All-llahun dhe në fe. Kurse në lidhje me friken nga vdekja, më së shumti kanë hasur tek mosha e vjetër.<sup>18</sup>

Pasi që feja njeriut i premtun një jetë të përjetshme, jetën e botes tjetër dhe xhennetin, ajo është edhe faktori kryesor që njeriun e drejton të besojë në fe dhe në All-llahun xh.sh. Por edhe rrethanat e frikës pas vdekjes dhe mendimi mbi xhehennemin mund të fusin dyshime dhe hamendje te njeriu në lidhje me ekzistimin e All-llahut dhe ta mohojë All-llahun,<sup>19</sup> andaj përveç motivit të vdekjes duhet që të kërkojmë edhe motive tjera për të besuar All-llahun xh.sh.

## **7. Ndjenja e fajësisë dhe mëkateve**

Thirrja për të besuar All-llahun dhe për të pranuar zbatimin e parimeve fetare, te njeriu mund të shkaktojë ndjenja të rebelimit dhe reagimit. Mos nënshtrimi me kalimin e kohës mund të krijojë ndjenjat e fajit dhe të mëkateve. Shpresa e shpëtimit e ndihmon njeriun t'i shpëtojë ndjenjat e fajit dhe shpresa për faljen e mëkateve bene që njeriu të qetësohet, andaj ajo ndikon edhe pozitivisht në motivimin e tij.

Fuqia e All-llahut është e pakufijshme andaj Ai pasi që t'i gjykojë mëkatarët i dënon ata, por besimi se shpëtimi nga ky dënim mund të realizohet vetëm me besimin në All-llahun dhe nënshtrimin ndaj urdhëresave dhe ndalesave të Tij, te njeriu krijon ndjenja dhe emocione besimi për All-llahun xh.sh. Këtu behet fjalë për një motiv me dy dimensione. Pra ndjenja e fajësisë dhe mëkateve me njëërën anë njeriun e drejton te besimi në All-llahun, kurse ana tjetër e drejton atë tek mohimi i All-llahut.

Në realitet ndjenja e fajit është universale. Çdo individ e ka përjetuar ndenjen e fajit pa marr parasysh sasinë e tij. Sjelljet kundër dëshirës së prindërve, shkelja e parimeve morale, kundërshtimet e kulturës sipas dëshirave dhe shijeve personale, apo thënë shkurt me fjalë të Freudit, kur egoja nuk i përgjigjet dëshirave të superegos por dëshirave të id'it te njeriu lind ndjenja e mëkateve. Njeriu afrohet më shumë me All-llahun kur tek ai lind frika se kundërshtimi i fesë është mëkat dhe pas kësaj pason dënimi, andaj lind ideja dhe dëshira e strehimit tek All-llahu. Por me këtë nuk do të thotë se ndjenjat e fajit dhe të mëkateve çdo herë njeriun e afrojnë tek All-llahu, por feja dhe vlerat morale ndonjëherë te njeriu mund të sjellin edhe rebelim ose reaksione të ndryshme.

## **8. Takimi me parimet e simboleve fetare**

Njeriu nuk është krijesë e cila i di saktët arsyet e besimit ose të mosbesimit. Ai nuk është as produkt i arsimit apo i mjedisit.<sup>20</sup> Ai me mendjen që ka gjerat i komenton dhe i vlerëson, pastaj ose i pranon ose i refuzon të gjitha ato fenomene dhe raste që vijnë nga shoqëria ose mjedisi.

Siç dihet në çdo shoqëri ka një ose disa lloj të feve. Andaj njeriu me kalimin e kohës has në shumë komentime në lidhje me simbolet e fetera në shoqërinë ku ai jeton. Ai në mënyrë direkte ose indirekte merr disa njohuri. I vëzhgon sjelljet fetare. Disa nga këto sjellje zgjojnë interes dhe shkaktojnë prirje, kurse disa nga këto sjellje mund edhe t'i refuzojë. Ky

---

<sup>17</sup> Köknel, po aty, f.23

<sup>18</sup> Vergote, po aty, f.160

<sup>19</sup> Vergote, po aty, f.161

<sup>20</sup> Vergote, Antoine, Din, İnanç ve İnançsızlık, Perktheu Prof. Dr. Veysel Uysal, Shpija Botuese Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Vakfi, 1999, f.23

pranim ose refuzim është lëvizës ose eklektik. Faktori i mjedisit më së shumti ndikon te mosha e femëjërisë, kurse pas moshës së pubertetit, me zhvillimin mendor dhe zgjerimit të njohurive që ka ai, në të shumtën e rasteve edhe pse gjerat i vlerëson dhe i komenton sipas mendimeve të tij individuale, nëse e arrin kënaqësinë e komenteve të fesë ajo e afron tek All-llahu.

## **Fund**

Njeriut është një krijesë me karakteristika të shumta biologjike, psiko-sociologjike, kulturore etj. dhe në përgjithësi këto karakteristika kanë efekte shumë të mëdha në jetën e individit. Këto karakteristika janë edhe paksa të përziera me njëra me tjetrën. Shumë efekte janë të ndërthurura në çështjen e besimit në Zotin dhe drejtimin e fesë, por këto efekte mund të ndryshojnë nga personi në person.

Nuk do të thotë se të gjitha efektet e cekura më lartë gjenden tek çdo individ dhe ndikojnë në besimin e All-llahut. Disa nga karakteristikat e cekura janë shkaktare që njeriun e fusin deri te besimi, kurse disa të tjerë mund edhe t'i largojnë nga besimi. Ajo çka është me rëndësi është se tek një individ mund jetë faktor vetëm frika dhe faji i mëkateve, ose njëra prej tyre. Pra lirisht mund të them se asnjë individ nuk beson në fe dhe në All-llahun pa ndonjë ndikim të faktorëve të lartëpërmendur. Ndoshta nuk i kam cekur të gjithë faktorët sepse ka edhe faktorë tjerë të cilët ndikojnë në çështjen e të besuarit në fe. Por ajo çka është më me rëndësi është se faktorët janë ata të cilët e nxisin njeriun deri në besim.

## **Literatura:**

**Arthur T. Jersild**, *Çocuk Psikolojisi*, Perktheu Gülseren Günçe, Shpija Botuese Ankara Üniversitesi Eğitim Fakültesi, Ankara, 1979

**Erich Fromm**, *Psikanaliz ve Din*, Përkthyes Şükrü Alkaput, İstanbul, 1990

**Hayati Hökelekli**, *Din Psikolojisi*, Shpija Botuese Türkiye Diyanet Vakfı, 1998

**Hayati Hökelekli**, *Ergenlik Çağı Gençlerinin Dini Gelişimi*, Tem e Doktoratures 1983

**Hüseyin Peker**, *Din ve Ahlak Eğitimi, Psikolojik ve Metodik Esasları*. Samsun, 1991

**Grom Bernhart**, *Religion Psychologie*, Munchen und Vandenhock, Transmeton Prof. Dr. Hüseyin Peker, *Din Psikolojisi*, Shtëpia Botuese Çamlıca, 1992

**Özcan Köknel**, *Korkular*, İstanbul, 1991

**Vergote Antione**, *Psychologie Religieuse*, Bruxelles, 1966, Transmeton Prof. Dr. Hüseyin Peker, *Din Psikolojisi*, Shtëpia Botuese Çamlıca

**Vergote Antoine**, *Din, İnanç ve İnançsızlık*, Perktheu Prof. Dr. Veysel Uysal, Shpija Botuese Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Vakfı, 1999

**Ziya Dalat**, *Çocuk ve Genç Ruhü*, Ankara, 1956